

Demensi me trupat Lewy (Lewybodydemens)

FLETUSHKA FAKTIKE NGA QENDRA SUEDEZE PËR DEMENS

Lewykroppsdemens • faktablad på albanska

Një diagnozë relativisht e re

Demens është emër i përbashkët për një varg simptomash, që vështirësojnë të menduarit, planifikimin dhe komunikimin. Simptomat shkaktohen nga sëmundjet e ndryshme dhe dëmtimet e trurit. Një ndër sëmundjet më të rëndomta të demensit është demensi me trupat Lewy, i ashtuquajtur "Lewybodydemens".

Demensi me trupat Lewy (Lewybodydemens), është diagnozë relativisht e re dhe zakonisht shfaqet tek personat në moshën mbi 65 vjeçare. Sëmundja ka marrë emrin simbas proteinës, që grumbullohet në tru dhe quhet "trupat Lewy", të cilat janë tipike për këtë sëmundje.

Disa simptoma tipike për sëmundjen

Demensi me trupat Lewy shkakton haluçinacione, personat parafytyrojnë sende apo persona, që në të vërtetë nuk ekzistojnë. Sëmundja karakterizohet nga vështirësi të përcaktimit të distancës dhe perceptimit tredimensional, e për këtë shkak vështirëson orientimin dhe kryerjen e punëve praktike nga i sëmuri. Përditshmëria vështirësohet gjithashtu nga shtërngimi i muskulaturës dhe lëvizjeve të ngadalsuara. Simptomat fizike lajmërohen në fazën e hershme të sëmundjes dhe më së tepërmi ndërlidhen me sëmundjen e Parkinsonit.

Në fillim çfaqen qrrregullime në gjumin e natës

Demensi me trupat Lewy fillon në mënyrë tinzare. Shënja e parë e sëmundjes mund të paraqitet me gjumë të çrregulluar. Përsoni bën gjumë të parhatshëm, thërret me zë të lartë dhe bën shumë lëvizje në shtrat gjatë fjetjes.

Përsoni e ndjen vehten të hutuar pa ndonjë arsye. Harresa dhe vështirësitë për të gjetur fjalët, të cilat janë të zakonshme në fillim të sëmundjes së demensit, në rastin me trupat Lewy janë më pak të theksuara.


Gjëndja shëndetësore ndryshon

Gradualisht simptomat bëhen më të theksuara dhe përkeqësohen funksionet mendore dhe trupore. Përsoni shpesh ndjen lodhje dhe flenë më shumë dhe shpesh edhe gjatë ditës. Sëmundja vështirëson përqëndrimin e përsonit. Tipike për demensin me trupat Lewy, është se gjëndja e tij ndryshon nga dita në ditë. Gjithashtu tensioni i gjakut, që zakonisht është i ulët mund të ndryshoj në mënyrë të pa sqarueshme.

E rëndësishme diagnostifikimi i hershëm i sëmundjes

Demensi me trupat Lewy i ashtu quajtur Lewybodydemens, nuk mund të konstatohet me disa analiza të thjeshta mjeksore. Diagnostifikimi bazohet në një varg testimesh, kërkimesh si dhe besida me pacientin dhe familjarët. Kontrollat mjeksore zgjasin nga katër deri në gjashtë javë. Është me rëndësi që kontrollat mjeksore të fillojnë sa më herët, në mënyrë që përsoni të merrë ndihmën dhe të fillojë terapinë në kohë të duhur.

Sot ende nuk ekzistojnë barna për shërimin e sëmundjes, por ekzistojnë mënyra të ndryshme për ti zvogluar simptomat e sëmundjes.



Mënyra të ndryshme për uljen e nivelit të simptomave

Karakteristikë për Lewybody demens, është se barnat neuroleptike, që përdoren kundër haluçinacioneve, në rastet e këtij lloji të demensit, kanë efekt negativ dhe nuk duhet të përdoren. Por, disa barna, që trajtojnë sëmundjet e Alzheimerit dhe të Parkinsonit, kanë efekt pozitiv sidomos në fillimin e hershëm të sëmundjes.

Përsonave me Lewybody demens i nevojitet shumë ndihmë. Mjetet ndihmëse dhe ndihmesa të ndryshme, mund ta lehtësojnë përditshmerinë e të sëmurit. Gjithashtu është me rëndësi sqarimi i simptomave të shfaqura, në mënyrë që të planifikohet jeta e mëtejshme e këtyre përsonave.

Me kalimin e kohës nevojitet ndihma dhe mbështetja nga institucionet sociale dhe shëndetsore.

30 janar 2016 • Svenskt Demenscentrum®

Më shumë informata në gjuhët e ndryshme mund ti lexoni në portalin Qendra Suedeze për demens:
www.demenscentrum.se/Faktablad



Svenskt Demenscentrum

Svenskt Demenscentrum, Gävlegatan 16, 113 30 Stockholm, 08 - 690 58 00, info@demenscentrum.se

www.demenscentrum.se